



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, 5 shkurt 2021
Nr. ref.: RK 1700/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI124/20

Parashtrues

MuhamedAli Ceçşulmedine

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit, UZVP. ARJ. nr. 139/2019 të
Gjykatës Supreme, të 18 nëntorit 2019**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga MuhamedAli Ceçşulmedine me vendbanim në Komunën e Prizrenit (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [UZVP. ARJ.nr.139/2019] të 18 nëntorit 2019 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) në lidhje me Aktvendimin [A.A.nr.534/2018] e 8 majit 2019 të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) dhe Aktvendimin [A.nr. 435/13] e 5 qershorit 2018 të Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).
3. Parashtruesi i kërkesës, Aktgjykimin e kontestuar e ka pranuar më 28 korrik 2020.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Supreme, përmes së cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenet 3 [Barazia para Ligjit], 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr.03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 32 (Parashtrimi i Kërkesave dhe Përgjigjeve) të Rregullores së punës të Gjykatës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 11 gusht 2020, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) pranoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës të dorëzuar përmes postës.
7. Më 26 gusht 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bajram Ljatifi (kryesues), Safet Hoxha dhe Radomir Laban.
8. Më 3 shtator 2020, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe i kërkoi që të dorëzojë formularin e plotësuar të kërkesës, si dhe të dorëzojë kopjet e (i) Aktgjykimit të kontestuar [UZVP. ARJ. nr. 139/ 2019] të 18 nëntorit 2019 të Gjykatës Supreme; (ii) Aktvendimit [A.A.nr.534/2018] të 8 majit 2019 të Gjykatës së Apelit; (iii) Aktvendimit [A. nr. 435/13] të 5 qershorit 2018 të Gjykatës Themelore; (iv) Vendimit [10/2013] të 21 janarit 2013 të Agjencisë për Regjistrim Civil në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme (në tekstin e mëtejme: Agjencia për Regjistrim Civil); (v) Vendimit [200/1606] të 23 dhjetorit 2011 të Zyrës së Gjendjes Civile në Prizren (në tekstin e mëtejme: Zyra e Gjendjes

Civile); si dhe (vi) ankesës së parashtruar në Gjykatën e Apelit dhe të kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të parashtruar në Gjykatën Supreme.

9. Më 16 shtator 2020, Gjykata i pranoi dokumentet e kërkuara nga parashtruesi i kërkesës.
10. Më 29 shtator 2020, Gjykata (i) i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme; dhe (ii) i dërgoi Gjykatës Themelore kërkesën që të dorëzojë fletëkthesën e cila dëshmon se kur parashtruesi i kërkesës e ka pranuar Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme.
11. Më 30 shtator 2020, Gjykata Themelore dorëzoi fletëkthesën e kërkuar, e cila dëshmon që parashtruesi i kërkesës Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme e ka pranuar më 28 korrik 2020.
12. Më 20 janar 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarese raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

13. Bazuar në shkresat e lëndës, në vitin 2011, kishte ndërruar jetë e ëma e parashtruesit të kërkesës. Si rrjedhojë, parashtruesi i kërkesës në Zyrën e Gjendjes Civile kishte parashtruar kërkesë për nxjerrjen e Certifikatës së Vdekjes të së ëmës së ndjerë, të cilën certifikatë e kishte pranuar më 19 dhjetor 2011.
14. Në një datë të paspecifikuar, si rezultat i pakënaqësisë së tij me mbiemrin e shënuar "*Cezülmedini*" në Certifikatën e Vdekjes të së ëmës së ndjerë, parashtruesi i kërkesës në Zyrën e Gjendjes Civile paraqiti kërkesë për korrigjimin e mbiemrit të saj në Regjistrin Themelor të Lindurve, në Regjistrin e Kurorëzimeve dhe në Regjistrin Themelor të Vdekurve. Në kërkesën e tij parashtruesi i kërkesës në mënyrë specifike kërkoi që mbiemri i së ëmës i shënuar "*Cezülmedini*" të korrigjohet në "*Ceyşülmedine*".
15. Më 23 dhjetor 2011, Drejtori i Administratës në Zyrën e Gjendjes Civile përmes Aktvendimit [nr. 200/1606] refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës për korrigjimin e mbiemrit të së ëmës në regjistrat përkatës. Përmes këtij Aktvendimi u arsyetua se në Certifikatën e Kurorëzimit të 17 marsit 1941, Certifikatën e Lindjes si dhe në Certifikatën e Vdekjes, mbiemri i së ëmës së ndjerë është "*Cezülmedini*" dhe jo "*Ceyşülmedine*".
16. Më 13 janar 2012, kundër Aktvendimit të lartcekur të Departamentit të Administratës në Zyrën e Gjendjes Civile, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Agjencinë për Regjistrim Civil.
17. Më 21 janar 2013, Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave i Agjencisë për Regjistrim Civil, përmes Vendimit [nr. 10/013] refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar, duke vërtetuar Aktvendimin [nr.200/1606] e 23 dhjetorit 2011 të Zyrës së Gjendjes Civile.

18. Në bazë të shkresave të lëndës, rezulton se më 29 mars 2013, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur kërkesëpadi në Gjykatën Supreme. Më 2 shtator 2013, Gjykata Supreme e kishte njoftuar parashtruesin e kërkesës se si rezultat i hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 06/L-054 për Gjykatat, kompetente për kërkesëpadinë e tij është Gjykata Themelore. Për pasojë, më 4 shtator 2013, parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesëpadi në Gjykatën Themelore.
19. Më 28 janar 2014, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [P.nr. 2237/12], shpalli veten jo kompetente në këtë çështje juridike dhe e hodhi poshtë kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës. Gjykata Themelore, ndër tjerash, kishte konstatuar se “ [...] rezulton qartë se për vendosjen në lidhje me kërkesën për gabime dhe për përmirësimin e të dhënave në librat e ofiqarisë, është kompetent organi komunal dhe se procedura e cila zbatohet për këto kërkesa është procedura administrative si dhe akti i cili merret si rezultat i kësaj procedure paraqet akt administrativ”.
20. Më 28 janar 2014, parashtruesi i kërkesës në Gjykatën Themelore kishte parashtruar kërkesë për lirim nga “detyrimi i pagesës së taksës gjyqësore” për ushtrimin e ankesës kundër Aktvendimit [P.nr. 2237/12] të 28 janarit 2014, ndërsa më 20 shkurt 2014, kundër Aktvendimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit, duke theksuar, ndër të tjera, se (i) bazuar në shkresën e 2 shtatorit 2013 të Gjykatës Supreme, përmes së cilës ishte njoftuar se kompetente përkitazi me kërkesëpadinë e tij ishte Gjykata Themelore, më 4 shtator 2013, kishte parashtruar kërkesëpadi në Gjykatën Themelore; dhe (ii) konstatimi i Gjykatës Themelore se e njëjta është jokompetente për të shqyrtuar çështjen e tij është në kundërshtim me këtë shkresë të Gjykatës Supreme. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjykata e Apelit që ta aprovojë ankesën e tij, duke e shfuqizuar Aktvendimin e kontestuar të Gjykatës Themelore dhe duke e kthyer çështjen e tij në rivendosje.
21. Më 13 qershor 2014, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [P.nr. 2237/12], refuzoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës për lirim nga pagesa e taksës gjyqësore. Kundër këtij Aktvendimi, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit.
22. Më 11 shkurt 2019, Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimit [Ac. nr. 3787/14] (i) refuzoi si të pathemeltë ankesën e parashtruesit të kërkesës kundër Aktvendimit [P.nr. 2237/12] të 13 qershorit 2014, lidhur me kërkesën për lirim nga pagesa e taksës gjyqësore; ndërsa (ii) aprovoi ankesën e parashtruesit të kërkesës kundër Aktvendimit [P.nr. 2237/12] të 28 janarit 2014, përmes të cilit Gjykata Themelore e kishte shpallur veten jokompetente dhe çështjen e ktheu në Gjykatën Themelore në rivendosje.
23. Përkitazi me Aktvendimin [P.nr. 2237/12] e 28 janarit 2014 të Gjykatës Themelore, Gjykata e Apelit, ndër të tjera, theksoi se (i) në bazë të këshillës juridike të dhënë në Vendimin e Agjencinë për Regjistrim Civil, parashtruesi i kërkesës është udhëzuar që të parashtrojë kërkesëpadi në konflikt administrativ në afat prej tridhjetë (30) ditësh në Gjykatën Supreme; dhe (ii) parashtruesi i kërkesës kishte shfrytëzuar këtë mjet juridik, dhe për pasojë më 2 shtator 2013

nga Gjykata Supreme është njoftuar se kompetente për këtë çështje administrative është Gjykata Themelore. Rrjedhimisht, Gjykata e Apelit vendosi që çështja të kthehet në rivendosje në Gjykatën Themelore *“me sugjerimin që më rastin e procedimit të serishëm të vlerësoj kompetencën dhe nëse vlerëson se Divizioni civil është jo kompetent atëherë lëndën ta dërgoj në departamentin përkatës të të njëjtës gjykatë”*.

24. Më 5 qershor 2018, Gjykata Themelore, përmes Aktvendimit [A.nr.435/13] e hodhi poshtë kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës për shkak të mos pagesës së taksës gjyqësore. Gjykata Themelore, ndër të tjera, kishte theksuar se (i) padia fillestare në këtë gjykatë ishte dorëzuar më 29 mars 2013; ndërsa (ii) më 1 janar 2017, parashtruesit të kërkesës i është dërguar vërejtja për pagesën e taksës gjyqësore, bazuar në të cilën, e njëjta duhet të paguhet brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, *“nën kërcënimin e hedhjes poshtë të padisë”*.
25. Më 7 shtator 2018, kundër Aktvendimit të lartcekur parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit, duke pretenduar se i njëjti është liruar nga pagesa e taksës gjyqësore.
26. Më 8 maj 2019, Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimit [A.A.nr. 534/2018] ankesën e parashtruesit të kërkesës e hodhi poshtë si të pasaftshme. Gjykata e Apelit, ndër tjerash, theksoi se (i) në bazë të fletëkthesës, Aktvendimi i kontestuar i Gjykatës Themelore parashtruesit të kërkesës i ishte dorëzuar më 16 gusht 2018; (ii) në bazë të paragrafit 2 të nenit 49 (Procedura sipas mjeteve juridike) të Ligjit nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative (në tekstin e mëtejme: LKA) dhe këshillës përkatëse juridike në Aktvendimin e kundërshtuar, parashtruesi i kërkesës ka pasur të drejtë që ankesën e tij ta paraqesë pesëmbëdhjetë (15) ditë pas pranimit të Aktvendimit të kontestuar, respektivisht deri më 31 gusht 2018. Për pasojë, Gjykata e Apelit duke iu referuar datës së dorëzimit të ankesës së parashtruesit të kërkesës përmes postës më 7 shtator 2018, konstatoi se ankesa ishte dorëzuar jashtë afatit të përcaktuar me ligj, dhe rrjedhimisht bazuar në nënparagrafin 1 të nenit 34 [pa titull] të LKA-së, të njëjtën e hodhi poshtë si të pasaftshme.
27. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të Aktvendimit të lartcekur në Gjykatën Supreme, duke pretenduar *“zgjidhje të padrejtë”*, *“arsyetimit jo të plotë, sipërfaqësor dhe të mangët”*, dhe *“shkelje të të drejtave të njeriut dhe diskriminim”*.
28. Më 18 nëntor 2019, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [UZVP.ARJ. nr. 9/2019] kërkesën e parashtruesit të kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të Aktvendimit të lartcekur të Gjykatës së Apelit e refuzoi si të pabazuar, duke konfirmuar vendimmarrjen në Gjykatën e Apelit.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

29. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi [UZVP. ARJ. nr. 139/2019] i 18 nëntorit 2019 i Gjykatës Supreme është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenet 3 [Barazia para Ligjit], 24 [Barazia para

Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

30. Parashtruesi i kërkesës, ndër tjerash, thekson se (i) Gjykata Supreme nuk e ka marrë parasysh arsyetimin e tij se ankesa e dorëzuar pas afatit në Gjykatën e Apelit ishte si rezultat i sëmundjes së tij, lidhur me të cilën janë dorëzuar dëshmitë e nevojshme; (ii) mbiemri i ëmës së tij është i falsifikuar nga një zyrtar i Zyrës së Gjendjes Civile, duke theksuar se të gjitha provat e nevojshme përkitazi me mbiemrin e saktë të familjes janë dorëzuar në Gjykatën Themelore përmes kërkesëpadisë së tij të 4 shtatorit 2013; dhe (iii) *”nga Komuna e Prizrenit deri në Gjykatën Supreme, njerëzit në këto institucione më privojnë të drejtat e mia dhe themelore të njeriut më themelore, nuk lejojnë që mbiemri ynë familjar që ishte falsifikuar nga një kriminel të korrigohet”*.
31. Në fund, parashtruesi i kërkesës i drejtohet Gjykatës me kërkesën si në vijim: *“Unë dhe personat e tjerë me mbiemrin CEYSULMEDINE, dëshirojmë që të fshihet mbiemri i jonë i falsifikuar CEZULMEDINI nga Libri i Shërbimit Amzë i të vdekurve dhe të lindurve, dhe të regjistrohet ashtu si ka qenë. Ndërsa mbiemri ynë ka qenë CEYSULMEDINE, siç dëshmohet nga certifikatat e bashkëngjitura dhe letërnjoftimet. Falsifikuesi e ka falsifikuar këtë mbiemër diku në vitin 2008. Ndërsa kjo konstatohet me krahasimin e dorëshkrimit dhe bojës së shkrimit me rubrikat e tjera të plotësuara. Dëshiroj që Shërbimi Civil në Prizren ju ka dorëzuar për shikim Librin e Gjendjes Civile apo fotokopjen e faqes nga Libri i Gjendjes Civile në lidhje me mbiemrin tonë të falsifikuar”*.

Dispozitat relevante ligjore

Ligji Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative

Neni 34
[pa titull]

1. Gjykata e hedh poshtë padinë me vendim, nëse konstaton se:
 - 1.1. padia është paraqitur pas kalimit të afatit ose është e parakohëshme;[...]

Neni 49
(Procedura sipas mjeteve juridike)

1. Kundër vendimit të gjykatës, ankesa i paraqitet gjykatës kompetente, në mënyrën e caktuar në nenin 28 të këtij ligji.
 2. Ankesa paraqitet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, që nga dita e pranimit të vendimit të gjykatës.
- [...]

Vlerësimi i Pranueshmërisë së kërkesës

32. Gjykata së pari vlerëson nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
33. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

34. Në vazhdim, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohet në Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47 (Kërkesa Individuale)

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48 (Saktësimi i kërkesës)

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49 (Afatet)

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

35. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të autoritetit publik, përkatësisht Aktgjykimin [UZVP.ARJ.nr.139/2019] e 18 nëntorit 2019 të Gjykatës Supreme. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka qartësuar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit

dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

36. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në paragrafin (2) të rregullit 39 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të të cilave Gjykata mund të shqyrtojë kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Rregulli 39 (2) në veçanti përcakton që:

Rregulli 39
(Kriteret e pranueshmërisë)

"(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij."

37. Ky rregull, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ) por edhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë të papranueshme si "qartazi e pabazuar" një kërkesë në tërësinë e saj ose vetëm ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, pretendimet "qartazi të pabazuara" mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime "të shkallës së katërt"; (ii) pretendime që kategorizohen me një "mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes"; (iii) pretendime "të pambështetura apo paarsyetuara"; dhe në fund, (iv) pretendime "konfuzë dhe të paqarta". (Shih, më saktësisht, për konceptin e papranueshmërisë mbi bazën e një kërkesë të vlerësuar si "qartazi të pabazuar", dhe specifikat e katër kategorive të lartcekura të pretendimeve të kualifikuara si "qartazi të pabazuara", Udhëzuesin Praktik të GJEDNJ-së për Kriteret e Pranueshmërisë të 30 prillit 2020; pjesën III. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat qartazi të pabazuara, paragrafët 275 deri më 304).
38. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, në vlerësimin nëse e njëjta është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
39. Gjykata rikujton që rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me kërkesën e parashtruesit të kërkesës në Zyrën për Gjendje Civile në Komunën e Prizrenit për nxjerrjen e Certifikatës së Vdekjes të së ëmës së tij të ndjerë. Parashtruesi i kërkesës i pakënaqur me mbiemrin e vendosur në këtë certifikatë, në Zyrën për Gjendje Civile në Komunën e Prizrenit parashtroi kërkesë për korrigjim e mbiemrit në Regjistrin Themelor të Lindurve, në Regjistrin e Kurorëzimeve dhe në Regjistrin Themelor të Vdekurve. Zyra për Gjendje Civile dhe Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave në Agjencinë për Regjistrim Civil, refuzuan ankesën e

parashtruesit të kërkesës si të pabazuar. Më pas, parashtruesi i kërkesës iu drejtua gjykatave të rregullta të cilat e refuzuan gjithashtu kërkesën e tij si të pabazuar. E para, përkatësisht Gjykata Themelore, e hodhi poshtë për shkak të mos pagesës së taksës gjyqësore; e dyta, përkatësisht Gjykata e Apelit, e hodhi poshtë si të pasaftshme; ndërsa Gjykata Supreme konfirmoi Aktvendimin e Gjykatës së Apelit lidhur me paafatshmërinë e ankesës. Parashtruesi i kërkesës, siç është sqaruar më lart, i konteston këto konstatime para Gjykatës, duke pretenduar shkelje të neneve 3 [Barazia para Ligjit], 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës. Në mbështetje të pretendimeve për shkelje të këtyre neneve kushtetuese, parashtruesi i kërkesës thekson se (i) Gjykata Supreme nuk ka marrë parasysh arsyetimin e tij se ankesa e dorëzuar pas afatit në Gjykatën e Apelit ishte si rezultat i sëmundjes së tij; dhe (ii) mbiemri i së ëmës së tij të ndjerë është i falsifikuar, duke kërkuar nga Gjykata “*korrigjimin e mbiemrit*” përkatës.

40. Gjykata, bazuar në praktikën e saj gjyqësore dhe atë të GJEDNJ-së, vlerëson se pretendimet e parashtruesit të kërkesës janë pretendime “*të pambështetura apo paarsyetuara*”. Kjo sepse, parashtruesi i kërkesës vetëm e ka përmendur shkeljen e neneve të Kushtetutës, duke mos ofruar asnjë arsyetim dhe duke mos mbështetur pretendimet e tij rreth mënyrës se si Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme, përfshirë edhe vendimet e gjykatave të shkallës më të ulët, mund të kenë rezultuar në shkeljen e të drejtat dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenet 3, 24, 31 dhe 54 të Kushtetutës, respektivisht.
41. Gjykata rikujton se ajo vazhdimisht ka theksuar se vetëm përmendja e një neni të Kushtetutës, pa arsyetim të qartë dhe adekuat se si është shkelur ajo e drejtë, nuk mjafton si argument për të aktivizuar makinerinë e mbrojtjes që ofron Kushtetuta dhe Gjykata, si institucion që përkujdeset për respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut. (Shih, në këtë kontest, rastet e Gjykatës KIO2/18, parashtrues *Qeveria e Republikës së Kosovës [Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor]*, Aktvendim për papranueshmëri, i 20 qershorit 2019, paragrafin 36; dhe KI95/19, parashtrues *Ruzhdi Bejta*, Aktvendim për papranueshmëri i 8 tetorit 2019, paragrafët 30-31; shih, gjithashtu, Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 30 prillit 2020 për Kriteret e Pranueshmërisë; pjesën I. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat Qartazi të Pabazuara; 4. Ankesat e paarsyetuara: mungesa e provave, paragrafët 300 deri më 303).
42. Gjykata, gjithashtu rikujton se, duke u bazuar në nenin 48 të Ligjit dhe paragrafët (1) (d) dhe (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës dhe praktikën e saj gjyqësore, ajo vazhdimisht ka theksuar se (i) palët kanë detyrim që të qartësojnë saktësisht dhe në mënyrë adekuate të paraqesin faktet dhe pretendimet; dhe gjithashtu (ii) të dëshmojnë dhe në mënyrë të mjaftueshme të mbështesin pretendimet e tyre për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata, bazuar në sqarimet e mësipërme, konsideron që ky nuk është rasti.
43. Prandaj, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të neneve 3, 24, 31 e 54 të Kushtetutës, janë pretendime “*të pambështetura apo paarsyetuara*”, dhe rrjedhimisht, të papranueshme si qartazi të pabazuara në

bazë kushtetuese, siç është përcaktuar përmes paragrafit (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenet 20, 47 dhe 48 të Ligjit dhe rregullit 39 (2) të Rregullores së punës, më 20 janar 2021, njëzëri:

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Gresa Caka-Nimani

Gresa Caka-Nimani



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

Arta Rama-Hajrizi